

Katalogu i Standardeve Shqiptare - 2011



Është publikuar Katalogu i Standardeve Shqiptare 2011. Katalogu është botimi më i rëndësishëm i vitit lidhur me standardet dhe aktualisht ky botim siguron informacion mbi statusin e tyre deri në periudhën Prill 2011 .

Informacionin mbi statusin e standardeve për muajt në vazhdim e gjeni në Buletinet Informative që publikohen në *hard copy* dhe elektronikisht në faqen tonë të internetit <http://www.dps.gov.al/buletinet.php>.

Katalogu është ndarë në tre seksione sipas fushave, dhe për secilin seksion është përdorur një ngjyrë e caktuar.

Botimi nis me **Parathënien** e cila jep një përshkrim mbi përmbajtjen e katalogut; klasifikimi ndërkombëtar për standardet, si të gjejmë një standard sipas një përmbajtje të dhënë, si të gjejmë një standard sipas numrit të tij, si të blejmë një standard dhe se ku mund të gjendet katalogu.

Struktura e përmbajtjes – Synon të sigurojë mundësitë optimale për zgjedhjen e standardeve të ndërlidhura me përmbajtjet e tyre, si dhe për të lehtësuar radhën e vendosjes. *Struktura e përmbajtjes* së Katalogut është bazuar në klasifikimin ndërkombëtar për standardet (ICS).

Lista e standardeve të klasifikuara sipas subjektit – Standardet shqiptare dhe dokumentet e standardizimit, janë klasifikuar në këtë listë sipas fushave, grupeve dhe nëngrupeve në përputhje me *Strukturën e përmbajtjes*. Lista e standardeve të klasifikuara sipas përmbajtjes, përmban informacionin bibliografik të mëposhtëm:

- numrin e referencës;
 - numrin e faqeve të standardit;
 - kodin e çmimit;
 - Komitetin Teknik;
 - titullin e standardit;
 - titullin e një pjese specifike të standardit.



Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit

Lista e standardeve të shfuqizuara – Në këtë seksion jepet lista e standardeve të shfuqizuara, data e shfuqizimit, ICS-ja si dhe standardi zëvendësues, nëse ka të tilla.

Katalogun mund ta gjeni *online* në faqen tonë të internetit www.dps.gov.al, në link-un <http://www.dps.gov.al/dpsonline/search.php> si dhe me CD në zyrat e DPS.

Në të dy format e tij, ndërfaqja e përdorimit është e thjeshtë. Mjafton të plotësoni një minimum fushash për të gjetur standardin që ju kërkoni. Për ta përdorur këtë ndërfaqe do t'ju ndihmojë edhe Manuali i përdorimit i cili gjendet në CD dhe *online*.

Katalogu i Standardeve Shqiptare 2011 në të gjitha format e tij është falas, mos ngurroni të na kontaktoni për të marrë kopjen tuaj.

Për më tepër informacion:

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit - DPS

Tel: + 355 4 222 62 55; + 355 4 223 48 45

Fax: + 355 224 71 77

E-mail: info@dps.gov.al; dps_standard@yahoo.com

Web: www.dps.gov.al